



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 36

Tiranë – E premte, 13 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 8/2026, datë 28.1.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.....	2815
Dekret i Presidentit nr. 68, datë 12.2.2026	Për shpallje ligji.....	2827
Ligj nr. 10/2026, datë 28.1.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.....	2827
Dekret i Presidentit nr. 54, datë 11.2.2026	Për shpallje ligji.....	2840
Deklaratë e Kuvendit datë 12.2.2026	Për pafajësinë e udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.....	2840



LIGJ
Nr. 8/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 6 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në titullin e nenit hiqen fjalët “të kryera nga shtetas shqiptarë”.

¹ “Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

1. 2001/500/JHA: Vendimi kuadër i Këshillit i 26 qershorit 2001 mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi, numri CELEX 32001F0500, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 182, datë 5.7.2001, f. 1.

2. Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA i 25 tetorit 2004, që përcakton dispozitat minimale mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës, numri CELEX 32004F0757, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 355, datë 11.11.2004, f. 8.

3. Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2002/629/JHA, numri CELEX 32011L0036, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 101, datë 15.4.2011, f. 1.

4. Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2011 për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit

2. Në paragrafin e parë pas togfjalëshit “shtetas shqiptarë” shtohet togfjalëshi “tërësisht ose pjesërisht”.

3. Në paragrafin e dytë pas fjalës “shqiptar” shtohen fjalët “ose për një shtetas të huaj apo person pa shtetësi me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë”.

4. Fjalja e dytë e paragrafit të dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kushti për dënueshmërinë e njëkohshme në territorin e shtetit tjetër nuk zbatohet në rastet e:

a) krimeve të korrupsionit në sektorin publik;

b) ushtrimit të ndikimit të paligjshëm;

c) trafikimit të qenieve njerëzore;

ç) abuzimit seksual me fëmijë të mitur, shfrytëzimit seksual të fëmijëve të mitur, shfrytëzimit të prostitucionit me fëmijë të mitur, pornografisë dhe shfaqjeve pornografike me fëmijë.”.

Neni 2

Në nenin 7 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë pas fjalës “penale” shtohet togfjalëshi “tërësisht ose pjesërisht”.

2. Në paragrafin e dytë fjalët “ose të shtetasit shqiptar” zëvendësohen me fjalët “të shtetasit shqiptar ose të një shtetasi të huaj apo të një personi

2004/68/JHA, numri CELEX 32011L0093, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 335, datë 17.12.2011, f. 1.

5. Direktiva (BE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 majit 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE, numri CELEX 32015L0849, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 141, datë 5.6.2015, f. 73.

6. Direktiva (BE) 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 marsit 2017 për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kornizë të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e Vendimit të Këshillit 2005/671/JHA, numri CELEX 32017L0541, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 88, datë 31.3.2017, f. 6.

7. Direktiva (BE) 2018/1673 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2018 për luftën kundër pastrimit të parave me anë të ligjit penal, numri CELEX 32018L1673, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 284, datë 12.11.2018, f. 22.



pa shtetësi me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Pas nenit 7/a shtohet neni 7/b me këtë përmbajtje:

“Neni 7/b

Juridiksioni në rast refuzimi të ekstradimit për veprat me qëllime terroriste

Ligji penal i Republikës është i zbatueshëm ndaj një shtetasi shqiptar, një shtetasi të huaj ose një shtetasi të huaj me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, që ka kryer një vepër të parashikuar në kreun VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi, kur:

a) personi është i pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe

b) autoritetet kompetente shqiptare kanë refuzuar të ekstradojnë atë person drejt një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose drejt një shteti të tretë.

Juridiksioni i parashikuar në këtë nen zbatohet pavarësisht nga vendi ku është kryer ose dyshohet se është kryer vepra.”.

Neni 4

Paragrafi i shtatë i nenit 28 shfuqizohet.

Neni 5

Në paragrafin e parë të nenit 30 pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. “Ndalimi i përhershëm ose i përkohshëm i ushtrimit të aktiviteteve profesionale që përfshijnë kontakte të drejtpërdrejta dhe të rregullta me fëmijët e mitur.”.

Neni 6

Në paragrafin e parë të nenit 45 pas fjalës “shtetërore” shtohen fjalët “organeve publike që ushtrojnë autoritet shtetëror ose organizatave ndërkombëtare publike,”.

Neni 7

Në nenin 52/a bëhen këto shtesa:

1. Në paragrafin e tretë bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë pas fjalës “kriminale” shtohen fjalët “që heq dorë nga veprimtaria kriminale” dhe pas fjalës “tyre” shtohen fjalët “u siguron autoriteteve administrative ose gjyqësore informacione të cilat pëmdryshe ata nuk do të kishin qenë në gjendje t’i siguronin”.

b) Në fjalinë e dytë pas fjalës “dënimi” shtohen fjalët “përveç personit që ka kryer njërin nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

2. Pas paragrafit të tretë shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje:

“Fëmija i mitur, i dëmtuar nga veprat penale që kanë lidhje me shfaqjet pornografike me fëmijë, pornografinë e fëmijëve dhe prostitucionin e fëmijëve, përjashtohet nga dënimi.”.

Neni 8

Në nenin 100 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në titullin e nenit para fjalës “marrëdhënie” shtohen fjalët “Përfshirja në”.

2. Në paragrafin e parë bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Pas fjalëve “kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale” shtohen fjalët “ose përfshirja në akte seksuale”;

b) Fjalët “ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale” hiqen.

3. Pas paragrafit të parë shtohen paragrafi i dytë dhe i tretë me këtë përmbajtje:

“Kur përfshirja në akte seksuale me fëmijë të mitur kryhet nga një anëtar i familjes së fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cenueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim nga pesë gjer në



pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Shtrengimi, detyrimi ose kërcënimi i një fëmije të mitur, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, për t'u përfshirë në akte seksuale me një palë të tretë dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet. Kur kjo veprë është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cënueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim jo më pak se dhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.”

4. Në paragrafin e dytë togfjalëshi “marrëdhënia seksuale ose homoseksuale” zëvendësohet me togfjalëshin “përfshirja në akte seksuale”, togfjalëshi “me dhunë” zëvendësohet me fjalët “nëpërmjet shtrengimit, kërcënimit ose dhunës” dhe pas fjalës “shëndetin” shtohen fjalët “apo është rrezikuar jeta e tij”.

5. Në paragrafin e tretë fjala “vepra” zëvendësohet me fjalët “veprat e parashikuara në paragrafin e parë dhe të tretë të këtij neni”.

Neni 9

Në nenin 101 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e nenit para fjalës “marrëdhënie” shtohen fjalët “përfshirja në”.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Kryerja apo përfshirja në akte seksuale nëpërmjet shtrengimit, kërcënimit ose dhunës me fëmijë të mitur në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”

3. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Shtrengimi, detyrimi ose kërcënimi i një fëmije të mitur në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç për t'u përfshirë në akte seksuale me një palë të tretë dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”

4. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Veprat e parashikuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet:

a) kur kryhen nga një anëtar i familjes së fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që

ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cënueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore;

b) kur kryhen në bashkëpunim më shumë se një herë ose me dhunë; ose

c) kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin apo është rrezikuar jeta e tij.”

5. Në paragrafin e tretë fjala “vepra” zëvendësohet me fjalët “veprat e parashikuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni”.

Neni 10

Në nenin 108 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e tretë bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjala “e qëllimshme” zëvendësohet me fjalët “për qëllime seksuale”;

b) Fjalët “apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale” zëvendësohen me fjalët “edhe pa pjesëmarrjen e të miturit në këto akte seksuale”.

2. Pas paragrafit të tretë shtohen paragrafi i katërt, i pestë dhe i gjashtë me këtë përmbajtje:

“Përfshirja për qëllime seksuale si dëshmitar i abuzimit seksual i një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, edhe pa pjesëmarrjen e të miturit në këto akte seksuale, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Veprat e parashikuara në paragrafin e tretë dhe të katërt të këtij neni dënohen me burgim jo më pak se dhjetë vjet:

a) kur kryhen nga një anëtar i familjes së fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cënueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore;

b) kur kryhen me dhunë, në bashkëpunim ose më shumë se një herë; ose

c) kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin apo është rrezikuar jeta e tij.



Kur veprat e parashikuara në paragrafin e tretë dhe të katërt të këtij neni kanë sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së dëmtuar, dënohen me burgim jo më pak se njëzet vjet.”.

3. Në paragrafin e katërt fjalët “apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale” hiqen.

Neni 11

Pas nenit 108/a shtohet neni 108/b me këtë përmbajtje:

“Neni 108/b Organizimi i udhëtimeve për qëllime seksuale

Organizimi i udhëtimeve për të tjerë, përkundrejt shpërblimit apo jo, me qëllim kryerjen e ndonjë prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion ose në nenet 114, 114/a/1 dhe 117, pavarësisht parashikimeve ligjore përkatëse në vendin për ku organizohet udhëtimi, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Nëse kjo veprimtari kryhet nga personi juridik, gjykata, krahas dënimeve të tjera për të, vendos edhe mbarimin e personit juridik.”.

Neni 12

Në paragrafin e parë të nenit 110 togfjalëshi “gjer në një vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në dy vjet”.

Neni 13

Në nenin 110/a bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja, pritja ose strehimi i personave, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me qëllim shfrytëzimin, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Shfrytëzimi do të kuptohet si shfrytëzimi i prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, përfshirë lypjen ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, shfrytëzimin e bartjes së shtatzënisë për

të tretë, martesës së detyruar ose birësimit të paligjshëm, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Dhënia e pëlqimit nga një person, viktimë e trafikimit, ndaj shfrytëzimit, qoftë i synuar apo aktual, nuk përbën rrethanë lehtësuese, rrethanë për përjashtimin nga përgjegjësia penale ose dënimi i autorëve të veprës penale të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni kur është përdorur një nga mjetet e përcaktuara në atë paragraf.

Përdorimi i qëllimshëm i shërbimeve të ofruara nga një viktimë e një veprë penale, të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, kur viktima shfrytëzohet për të ofruar shërbime të tilla dhe përdoruesi i shërbimeve e di që personi që ofron shërbimin është viktimë e veprës penale në fjalë, dënohet me burgim nga dy gjer në dhjetë vjet.”.

3. Në paragrafin e dytë pas fjalës “femërore” shtohen fjalët “ose ndaj një personi të rritur me aftësi të kufizuara”.

4. Në paragrafin e katërt fjalët “shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin,” zëvendësohen me fjalët “ose kryhet duke përdorur dhunë të rëndë ose i sjell viktimës pasoja të rënda, duke përfshirë pasoja fizike ose psikologjike”.

5. Pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur autori ka lehtësuar ose kryer përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit shpërndarjen e imazheve, videove ose materialeve të ngjashme, me përmbajtje seksuale që përfshijnë viktimën, dënimi me burgim rritet me 1/4 e dënimit të dhënë.”.

Neni 14

Në paragrafin e dytë të nenit 114 togfjalëshi “me të mitur” hiqet.

Neni 15

Pas nenit 114 shtohet neni 114/a/1 me këtë përmbajtje:



“Neni 114/a/1

Shfrytëzimi i prostitucionit me të mitur

Nxitja, rekrutimi, shtrëngimi, detyrimi ose kërcënimi i një fëmije të mitur për të marrë pjesë në prostitucionin e fëmijëve, ose përfitimi nga ose shfrytëzimi i një fëmije për qëllime të tilla dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim gjashtë gjer në dhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Përfshirja në akte seksuale me një fëmijë të mitur, i cili përdoret për prostitucion të fëmijëve, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim jo më pak se dy vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Veprat e parashikuara në paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet:

a) kur kryhen nga një anëtar i familjes së fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cenueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paafësie fizike ose mendore;

b) kur kryhen me dhunë, në bashkëpunim ose më shumë se një herë; ose

c) kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin apo është rrezikuar jeta e tij.

Kur veprat e parashikuara në paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni kanë sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së dëmtuar, dënohen me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Për qëllime të këtij neni, togfjalëshi “prostitucion i fëmijëve” nënkupton përdorimin e një fëmije për akte seksuale ku vlera monetare ose çdo formë tjetër shpërblimi financiar ose shpërblime të tjera jepen ose premtohen si pagesë në këmbim të përfshirjes së fëmijës në akte seksuale, pavarësisht nëse kjo pagesë ose premtim i bëhet fëmijës apo një pale të tretë.”

Neni 16

Në nenin 117 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Prodhimi, importimi, futja, eksportimi, heqja, blerja, posedimi, shpërndarja, përhapja, reklamimi, transmetimi, ofrimi, furnizimi ose vënia në dispozicion i pornografisë së fëmijëve të mitur, si dhe aksesimi ose sigurimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.”

2. Pas paragrafit të dytë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për t'i kërkuar një fëmije të mitur për të ofruar pornografi me fëmijë që e përshkruan atë fëmijë, edhe kur fëmija nuk e ofron pornografinë e kërkuar, dënohet me burgim jo më pak se tre vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim jo më pak se një vit kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Për qëllime të këtij neni, togfjalëshi “pornografi e fëmijëve” nënkupton çdo material që përshkruan vizualisht:

a) një fëmijë të përfshirë në sjellje të qartë seksuale reale ose të simuluar;

b) çdo përshkrim i organeve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale;

c) çdo material që përshkruan vizualisht çdo person që duket se është një fëmijë i përfshirë në sjellje të qartë seksuale reale ose të simuluar, apo ndonjë përshkrim të organeve seksuale të çdo personi që duket të jetë fëmijë, kryesisht për qëllime seksuale; ose

ç) imazhe reale të një fëmije të përfshirë në akte qartësisht seksuale ose imazhe reale të organeve seksuale të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale.”

3. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Nxitja ose rekrutimi i një fëmije të mitur për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, përfitimi apo shfrytëzimi i një fëmije për qëllime të tilla, marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët ose ndjekja me vetëdije e një shfaqjeje të tillë dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim nga tre gjer në tetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.”



4. Pas paragrafit të tretë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Shtrengimi ose detyrimi i një fëmije për të marrë pjesë në shfaqje pornografike ose kërcënimi i një fëmije për qëllime të tilla dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katëmbëdhjetë vjeç ose me burgim gjashtë gjer në dhjetë vjet kur fëmija është në moshën katëmbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Veprat e parashikuara në paragrafët e pestë dhe të gjashtë të këtij neni dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet:

a) kur kryhen nga një anëtar i familjes së fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cenueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore;

b) kur kryhen me dhunë, në bashkëpunim ose më shumë se një herë; ose

c) kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin apo është rrezikuar jeta e tij.

Kur veprat e parashikuara në paragrafët e tretë dhe të katërt të këtij neni kanë sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së dëmtuar, dënohen me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Për qëllime të këtij neni, togfjalëshi “shfaqje pornografike” nënkupton një shfaqje e drejtuar për një audiencë, duke përfshirë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, të një fëmije të angazhuar në sjellje të qartë ose të simuluar seksuale, ose organet gjenitale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale.”.

Neni 17

Pas paragrafit të dytë të nenit 120 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Një gazetar i punësuar ose i vetëpunësuar, i regjistruar dhe i njohur si i tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pavarësisht nga shtetësia apo vendi ku ushtrohet aktiviteti, nuk mban përgjegjësi penale për veprën e shpifjes sipas këtij neni, për përhapjen me mirëbesim të të dhënave/thënieve ose çdo informacioni tjetër përmes shtypit, medias audiovizive, medias elektronike ose platformave të tjera të komunikimit publik, kur:

a) qëllimi kryesor është informimi i publikut për çështje me interes të përgjithshëm;

b) në momentin e publikimit, ai nuk ka dhe, në rrethanat konkrete, në mënyrë të arsyeshme, nuk mund të kishte dijeni se të dhënat apo informacionet faktike janë të rreme dhe ka bërë përpjekje të arsyeshme për të verifikuar saktësinë e tyre; dhe

c) pasi të jetë informuar nga personi i prekur ose nga autoritetet kompetente se të dhënat apo informacionet faktike janë haptazi të rreme ose qartazi të pasakta, ai vepron pa vonesë për të bërë një përgënjeshtim ose sqarim ose për t'i hequr ato ose për të çaktivizuar aksesin në to.

Për qëllimet e këtij neni, “përhapje me mirëbesim” do të thotë përhapje që plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin e tretë të këtij neni dhe kryhet në përputhje me rregullat etike e profesionale të gazetarisë, mbi baza faktike e të arsyeshme. Vlerësimet, opinionet, komentet, kritikët ose interpretimet, edhe kur janë therëse, të ekzagjeruara ose fyese, nuk konsiderohen shpifje në kuptim të këtij neni, përveç nëse përmbajnë, shprehimisht ose të nënkuptuara pretendime, fakte, të dhëna apo informacione objektivisht të rreme.”.

Neni 18

Në nenin 128/b bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja, pritja ose strehimi i të miturve, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi të miturit, me qëllim shfrytëzimin, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Shfrytëzimi do të kuptohet si shfrytëzimi i prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, përfshirë lypjen ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, shfrytëzimin e bartjes së shtatzënisë për të tretë, martesës së detyruar ose birësimit të paligjshëm, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Dhënia e pëlqimit nga një viktimë e trafikimit të të miturve ndaj shfrytëzimit, qoftë i synuar apo aktual, nuk përbën rrethanë lehtësuese ose rrethanë



për përjashtimin nga përgjegjësia penale e autorëve të veprës penale, të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, kur është përdorur një nga mjetet e përcaktuara në atë paragraf.

Përdorimi i qëllimshëm i shërbimeve të ofruara nga një viktimë e një vepre penale të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, kur viktima shfrytëzohet për të ofruar shërbime të tilla dhe përdoruesi i shërbimeve e di që personi që ofron shërbimin është viktimë e veprës penale në fjalë, dënohet me burgim nga dy gjer në dhjetë vjet.”.

3. Në paragrafin e tretë fjalët “apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme,” zëvendësohen me fjalët “nëpërmjet përdorimit të dhunës së rëndë ose i sjell viktimës pasoja të rënda, duke përfshirë pasoja fizike ose psikologjike ose rrezikon jetën e tij”.

4. Pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur autori ka lehtësuar ose kryer veprën përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit, shpërndarjen e imazheve, videove ose materialeve të ngjashme, me përmbajtje seksuale që përfshijnë viktimën, dënimi me burgim rritet me ¼ e dënimit të dhënë.”.

Neni 19

Pas nenit 143/a/7 shtohet neni 143/a/8 me këtë përmbajtje:

“Neni 143/a/8

Mashtrimi që prek interesat financiare të Bashkimit Evropian

Moszbulimi i informacionit në shkelje të një detyrimi specifik, përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota, që ka si efekt përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Evropian ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të Bashkimit Evropian, ose keqpërdorimi i fondeve të tilla për qëllime të tjera nga ato për të cilat ato janë dhënë dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Moszbulimi i informacionit në shkelje të një detyrimi specifik, përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota, që ka si efekt zvogëlimin e paligjshëm

të burimeve të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të Bashkimit Evropian, ose keqpërdorimi i një përfitimi të përfituar ligjërisht dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Kur veprat e parashikuara në paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni kryhen në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohen me burgim nga dy gjer në gjashtë vjet.

Kur të njëjtat vepra përfshijnë një shumë, që tejkalon 50 000 euro, dënohen me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”.

Neni 20

Në nenin 149/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë togfjalëshi “gjer në një vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në dy vjet”.

2. Në paragrafin e dytë togfjalëshi “gjer në dy vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në tre vjet”.

Neni 21

Në nenin 149/b bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë togfjalëshi “gjer në një vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në dy vjet”.

2. Në paragrafin e dytë togfjalëshi “gjer në dy vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në tre vjet”.

Neni 22

Pas paragrafit të parë të nenit 151 shtohen paragrafët i dytë dhe i tretë me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër e kryer në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cenon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.



Neni 23

Në paragrafin e parë të nenit 180/a togfjalëshi “deri në një vit” zëvendësohet me fjalët “deri në dy vjet”.

Neni 24

Pas paragrafit të fundit të nenit 199/a shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Kur ndërtimi i paligjshëm kryhet nga persona që ushtrojnë funksione publike në fushën e mbrojtjes, zhvillimit, planifikimit, mbikëqyrjes apo kontrollit të territorit, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë dhe me heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike deri në pesë vjet.

Kur ndërtimi i paligjshëm kryhet brenda zonave të mbrojtura, parqeve natyrore ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cenon infrastrukturën kritike, dënimi rritet me dy të tretat e dënimit të dhënë.”

Neni 25

Neni 200 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 200

Zënia e pronës

Zënia e tokës, publike apo private, pa titull ligjor, ndërtimi apo shfrytëzimi i çfarëdollojshëm, kur kryhet për qëllime përfitimi ekonomik apo veprimtarie biznesi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet në mënyrë të përsëritur ose në bashkëpunim, ose ka si pasojë pengimin e përdorimit të ligjshëm të tokës nga poseduesi i ligjshëm apo pronari, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Po kjo vepër kur kryhet në tokë që ndodhet brenda zonave të mbrojtura, parqeve natyrore ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cenon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet nga persona që ushtrojnë funksione publike në fushën e mbrojtjes, zhvillimit, planifikimit, mbikëqyrjes apo kontrollit të territorit, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet dhe

me heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike deri në pesë vjet.”.

Neni 26

Në nenin 206/a bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas paragrafit të parë shtohen paragrafët i dytë dhe i tretë me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër, e kryer në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cenon infrastrukturën kritike dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Në këto raste gjykata vendos që klasifikimi i tokës në zonat e prekura nga zjarri në pyje nuk mund të ndryshohet brenda një periudhe deri në tridhjetë vjet.”.

Neni 27

Pas paragrafit të parë të nenit 206/b shtohen paragrafët i dytë dhe i tretë me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër, e kryer në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

Kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cenon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga katër deri në shtatë vjet.”.

Neni 28

Në nenin 230 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin parë bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:



a) Fjala “panikut” zëvendësohet me fjalët “një gjendjeje të rëndë frike”;

b) Pas fjalës “të huaja” shtohen fjalët “ose një institucion apo organizatë ndërkombëtare”.

c) Pas fjalës “të huaja” shtohen fjalët “pavarësisht nëse është kryer një veprë penale apo jo”.

2. Në paragrafin e dytë bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a” togfjalëshi “plagosje të rëndë” zëvendësohet me fjalët “dëmtimin e shëndetit fizik ose mendor”;

b) Në shkronjën “ç” fjalët “apo të një platforme fikse” dhe “ose platformës fikse” hiqen;

c) Në shkronjën “g” fjalët “pengmarrjen ose rrëmbimin e personit dhe” zëvendësohen me fjalët “pengmarrjen, rrëmbimin e personit ose”;

ç) Në shkronjën “j” bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Pas fjalës “mbajtjen” shtohet fjala “përdorimin,”;

ii. Pas fjalës “blerjen” shtohet fjala “furnizimin,”;

iii. Pas fjalës “biologjike” shtohet fjala “radiologjike,”;

iv. Fjalët “për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë” zëvendësohen me fjalët “për zhvillimin e armëve kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore”;

d) Në shkronjën “ll” fjalët “me qëllim shkaktimin e vdekjes ose dëmtimeve të rënda trupore ose me qëllim shkaktimin e shkatërrimeve masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura” zëvendësohen me fjalët “duke shkaktuar vdekjen, rrezikimin e jetës ose dëmtime të rënda trupore ose duke shkaktuar shkatërrime masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura”.

dh) Shkronja “m” ndryshohet si më poshtë:

“m) shkatërrimin e rëndë dhe në përmasa të mëdha të pronës shtetërore ose publike, një sistemi transporti, një objekti infrastrukture, duke përfshirë një sistem informacioni, një platformë fikse të vendosur në shelfin kontinental, një vend publik ose pronë private që mund të rrezikojë jetën e njerëzve ose të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike”;

e) Pas shkronjës “m” shtohet shkronja “m/1” me këtë përmbajtje:

“m/1) ndërhyrjen e paligjshme në një sistem informacioni apo në të dhënat kompjuterike kur një akt i tillë është kryer kundër një sistemi informacioni

të infrastrukturës kritike ose shkakton dëmtime serioze”;

ë) Në shkronjën “n” bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Fjalët “shkaktimin e ndërprerjes së” zëvendësohen me fjalët “ndërhyrjen ose ndërprerjen e”.

ii. Pas fjalës “të rëndësishëm” shtohen fjalët “natyror thelbësor, duke rrezikuar jetën e personave”;

f) Pas shkronjës “n” shtohet shkronja “nj” me këtë përmbajtje:

“nj) vjedhjen me pasoja të rënda, shtrëngimin me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, si dhe falsifikimin e përdorimin e dokumenteve të falsifikuara me qëllim kryerjen e një veprë të parashikuar në këtë nen”;

2. Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste të parashikuara në këtë nen dënohet me burgim nga tetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 29

Në nenin 230/a bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, shkronja “a”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas fjalës “kryer” shtohen fjalët “ose për të kontribuar në kryerjen e”;

b) Fjalët “vepra me qëllime terroriste” zëvendësohen me fjalët “veprave të parashikuara në këtë kre”.

2. Në paragrafin e dytë, shkronja “a”, pas fjalës “përfshihen” shtohen fjalët “por jo të kufizuar vetëm në”.

Neni 30

Në nenin 231 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas fjalës “kryerjen” shtohen fjalët “ose për dhënien e kontributit në kryerjen”.

2. Pas fjalës “terroriste” shtohen fjalët “veprave të parashikuara në nenin 230, shkronjat “a” deri “m/1”, dhe nenin 234/a të këtij Kodi”.

3. Pas fjalës “ndërkombëtare” shtohen fjalët “por pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen”.

4. Fjalët “nëse nuk përbën veprë tjetër penale” hiqen.



5. Pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kur kjo vepër synon rekrutimin e fëmijëve, dënimi përkatës shtohet deri në një të dytën e tij.”.

Neni 31

Në nenin 232 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pas fjalës “zjarrit” fjala “dhe” zëvendësohet me një presje.

2. Pas togfjalëshit “armëve të tjera” fjala “dhe” zëvendësohet me fjalën “ose”.

3. Togfjalëshi “njerëzit dhe” zëvendësohet me fjalët “njerëzit, mjedisin ose”.

4. Pas fjalës “kryerjen” shtohen fjalët “ose për dhënien e kontributit në kryerjen”.

5. Pas togfjalëshit “veprimtari të tilla” shtohen fjalët “duke ditur se aftësitë e ofruara synohen të përdoren për këtë qëllim”.

6. Pas fjalës “ndërkombëtare” shtohen fjalët “dhe pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen”.

7. Fjalët “nëse nuk përbën vepër tjetër penale” hiqen.

8. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur kjo vepër synon stërvitjen e fëmijëve, dënimi përkatës shtohet deri në një të dytën e tij.”.

Neni 32

Neni 232/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 232/a

Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste

Thirrja, nxitja ose propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose financimin e terrorizmit, kryer nëpërmjet çdo forme komunikimi, shpërndarje apo promovimi të mesazheve, ideologjive apo materialeve që nxitin, inkurajojnë ose glorifikojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kryerjen e veprave me qëllime terroriste, mbështetjen ose miratimin e tyre, apo promovimin e objektivave, synimeve apo ideologjisë së organizatave terroriste, duke shkaktuar kështu rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla mund të kryhen, por pa qenë e nevojshme që këto vepra të

kryhen, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.

Neni 33

Pas nenit 232/a shtohet neni 232/a/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 232/a/1

Marrja e trajnimit për kryerjen e veprave me qëllime terroriste

Marrja e udhëzimeve, njohurive ose aftësive praktike nga një person tjetër për prodhimin ose përdorimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit dhe municioneve ose armëve të tjera ose lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, apo metodave ose teknikave të tjera specifike me qëllim kryerjen ose dhënien e kontributit në kryerjen e një veprë penale me qëllime terroriste, por pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen, dënohet me burgim jo më pak se shtatë vjet.”.

Neni 34

Neni 232/b shfuqizohet.

Neni 35

Pas nenit 232/b shtohen nenet 232/c dhe 232/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 232/c

Udhëtimi për qëllime terroriste

1. Kryerja e udhëtimit, me çdo mënyrë apo mjet, duke përfshirë falsifikimin ose përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt një shteti tjetër, me qëllim:

a) kryerjen ose kontributin në kryerjen e një veprë penale me qëllime terroriste, pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen;

b) pjesëmarrjen në veprimtarinë e një organizate terroriste sipas nenit 234/a të këtij Kodi, duke ditur se kjo pjesëmarrje do të kontribuojë në veprimtarinë kriminale të kësaj organizate; ose,



c) dhënien ose marrjen e trajnimit për kryerjen e veprave me qëllime terroriste, sipas neneve 232 dhe 232/a/1 të këtij Kodi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Kryerja e udhëtimit, në çdo mënyrë apo mjet, duke përfshirë falsifikimin ose përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, drejt territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim:

a) kryerjen ose kontributin në kryerjen e një vepre penale me qëllime terroriste sipas nenit 230 të këtij Kodi, pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen;

b) pjesëmarrjen në veprimtarinë e një organizate terroriste sipas nenit 230/a të këtij Kodi, duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në aktivitetin kriminal të kësaj organizate; ose,

c) dhënien ose marrjen e trajnimit për kryerjen e veprave me qëllime terroriste sipas neneve 232 dhe 232/a/1 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 232/ç

Organizimi ose lehtësimi i udhëtimit për qëllime terroriste

Organizimi, financimi, ofrimi i mjeteve, informacionit, dokumenteve, përfshirë falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, mjeteve të transportit apo çdo forme tjetër ndihme që lehtëson udhëtimin e një personi me qëllim kryerjen ose kontributin në kryerjen e një vepre penale me qëllime terroriste sipas nenit 230 të këtij Kodi, por pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen, pjesëmarrjen në veprimtarinë e një organizate terroriste sipas nenit 234/a të këtij Kodi, ose dhënien apo marrjen e trajnimit për qëllime terroriste sipas neneve 232 dhe 232/a/1 të këtij Kodi, duke ditur se kjo ndihmë jepet për një qëllim të tillë, dënohet me burgim nga shtatë deri në dymbëdhjetë vjet.”

Neni 36

Paragrafi i dytë i nenit 234/a ndryshohet si më poshtë:

“Pjesëmarrja në një organizatë terroriste ose në aktivitetet kriminale të një organizate terroriste, duke përfshirë sigurimin e informacionit ose burimeve materiale, falsifikimin apo përdorimin e dokumenteve të falsifikuara ose duke financuar aktivitetet e saj në çfarëdo mënyre, duke ditur se një

pjesëmarrje e tillë do të kontribuojë në veprimtarinë kriminale të organizatës terroriste, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.”

Neni 37

Pas paragrafit të katërt të nenit 237 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo vepër penale kryhet kundër një personi të punësuar ose të vetëpunësuar si gazetar, i regjistruar dhe i njohur si i tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pavarësisht nga shtetësia apo vendi ku ushtrohet aktiviteti, për shkak të ushtrimit të aktivitetit të tij profesional dhe kur cilësia e tij është e dukshme ose e njohur, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”

Neni 38

Pas paragrafit të katërt të nenit 238 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo vepër penale kryhet kundër një personi të punësuar ose të vetëpunësuar si gazetar, i regjistruar dhe i njohur si i tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pavarësisht nga shtetësia apo vendi ku ushtrohet aktiviteti, për shkak të ushtrimit të aktivitetit të tij profesional dhe kur cilësia e tij është e njohur ose e dukshme, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”

Neni 39

Në nenin 283 bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalës “shitja” shtohet fjala “ofrimi”.

b) Pas fjalës “tregtimi” shtohet fjala “ndërmjetësimi”.

c) Pas fjalës “dërgimi” shtohen fjalët “dërgimi në transit”.

ç) Pas fjalës “dorëzimi” shtohet togfjalëshi “në çdo formë”.

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur kryhet:

a) në bashkëpunim ose më shumë se një herë;

b) në sasira të mëdha të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe të farërave të bimëve narkotike;



c) me substanca narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda në shëndetin e personave ose kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave.”.

Neni 40

Paragrafi i dytë i nenit 283/a ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet kur kryhet:

- a) në bashkëpunim ose më shumë se një herë;
- b) në sasira të mëdha të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe të farërave të bimëve narkotike;
- c) me substanca narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda ose që kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave.”.

Neni 41

Paragrafi i dytë i nenit 284 ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet kur kryhet:

- a) në bashkëpunim ose më shumë se një herë;
- b) në sasira të mëdha të bimëve;
- c) me bimë që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda në shëndetin e personave ose që kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave.”.

Neni 42

Paragrafi i dytë i nenit 284/c ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur kryhet:

- a) në bashkëpunim ose më shumë se një herë;
- b) në sasira të mëdha të substancave narkotike dhe psikotrope;
- c) me substanca narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda në shëndetin e personave ose që kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave.”.

Neni 43

Në nenin 284/ç bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas fjalës “tranzitimi” shtohet fjala “transportimi”.

2. Pas fjalës “tregtimi” shtohet fjala “shpërndarja”.

Neni 44

Në nenin 287 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e parë bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a” bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

i. Pas fjalës “saj” shtohen fjalët “ose për të ndihmuar çdo person që është i përfshirë në kryerjen e veprës penale për t’iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tij”.

ii. Fjala “i veprës” zëvendësohet me fjalët “i një veprë”.

iii. Fjalët “ose i veprimtarisë kriminale” hiqen.

b) Në shkronjën “b” fjalët “ose i veprimtarisë kriminale” hiqen.

c) Në shkronjën “c” fjalët “ose i veprimtarisë kriminale” hiqen.

ç) Në shkronjën “d” fjalët “ose i veprimtarisë kriminale” hiqen.

2. Në paragrafin e dytë pas fjalës “profesionale” shtohen fjalët “nga subjekte të legjislacionit në fuqi për pastrimin e parave”.

3. Në paragrafin e katërt bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) vërtetohet se produktet që pastrohen rrjedhin nga një vepër penale, pa qenë e nevojshme të përcaktohen të gjitha elementet faktike ose të gjitha rrethanat që lidhen me atë vepër penale, përfshirë identitetin e personit që e ka kryer veprën.”.

b) Në shkronjën “d” fjalët “dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë” zëvendësohen me fjalët “dhe është e dënueshme në Republikën e Shqipërisë”.

4. Pas paragrafit të pestë shtohet paragrafi i gjashtë me këtë përmbajtje:

“Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për pasuri që është produkt i veprave penale që prekin interesat financiare të Bashkimit Evropian.”.



Neni 45

Pas nenit 293 shtohet neni 293/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 293/1

Pushimi i mjetit në karrexhatë në rresht të dytë

Pushimi i mjetit në karrexhatë në rresht të dytë, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me 2 mjete me pedal, 2 ciklomotorë me dy rrota ose 2 motorë me dy rrota, që pengon qartazi dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lëvizjen e automjeteve në shërbim të policisë, zjarrfikëseve e të autoambulancave apo shërbimeve të tjera të institucioneve, bllokun tërësisht rrugën, duke e bërë të pamundur kalimin e mjeteve të tjera ose shkakton bllokim total të rrugës për këmbësorët, duke u bërë pengesë serioze për sigurinë publike, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”.

Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.1.2026.

Shpallur me dekretin nr. 68, datë 12.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 68, datë 12.2.2026****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 8/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ**Nr. 10/2026**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES
SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja “a”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1

Përkufizime

Për qëllim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të kandidatit.

b) “Person i lidhur” është bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmija madhor i kandidatit, i cili për shkak të kësaj marrëdhënieje u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë ligj.

c) “Persona të tjerë të lidhur” janë personat e afërt deri në shkallë të dytë, personi i besuar, drejtuesi dhe ortakët e shoqërisë në të cilën kandidati ose personat e lidhur me të zotërojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi aksione ose kuota, si dhe çdo person fizik ose juridik, i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat.



ç) “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:

i. procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;

ii. deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

d) “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e kandidatit për anëtar të Këshillit dhe personave të lidhur të tij/saj sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat.”.

Neni 2

Në nenin 19 në pikën 3 pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) të mos kenë masë disiplinore në fuqi, të mos jenë shkarkuar më parë nga detyra si rezultat i një mase disiplinore, në rastin e ish-magjistratëve të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ose të mos kenë dhënë dorëheqjen pa iu nënshtruar këtij procesi, ndërkohë që kanë qenë subjekt rivlerësimi në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të mos jenë skualifikuar më parë nga pozicione të ndryshme për shkak të verifikimit të pasurisë dhe figurës, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.”.

Neni 3

Në nenin 20 në pikën 1, fjalia e parë, togfjalësh “4 muaj” zëvendësohet me togfjalëshin “10 muaj”.

Neni 4

Në nenin 21 pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“4. Avokatët e interesuar brenda 15 ditëve nga shprehja e interesit duhet të dorëzojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave private për kontrollin e pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë në përputhje me nenin 3/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

5. Brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, avokatët e interesuar dhe personat e lidhur me të së bashku me deklaratën e pasurisë duhet të paraqesin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive.

6. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave bazuar në deklaratet e pasurive zhvillon një procedurë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundimin të kontrollit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit harton brenda 30 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit raportin për subjektin dhe e përcjell pranë Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* sa më shpejt të jetë e mundur jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.

7. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, kandidatët e interesuar dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar sipas kërkesave të ligjit për informacionin e klasifikuar pranë këtij institucioni.



8. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit sipas ligjit brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve të vetëdeklarimit dhe bashkëpunon me autoritetet ligjzbatuese për realizimin e kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit. Në përfundim të procedurës së verifikimit Autoriteti harton raportin për subjektin dhe e përcjell pranë Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.”

Neni 5

Në nenin 22 pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Avokati i Popullit brenda 15 ditëve nga dorëzimi i shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqërues mbledh të dhëna për çdo person të interesuar nga Prokuroria e Përgjithshme, gjykata, administrata tatimore, autoritetet doganore, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe nga çdo autoritet disiplinor dhe person fizik ose juridik që kanë të dhëna të vlefshme për qëllime verifikimi. Për kontrollin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në shkronjat “c” deri në “e” të nenit 19 të këtij ligji, nëse është e nevojshme, Avokati i Popullit i drejtohet Dhomës Kombëtare të Avokatisë për saktësinë e informacionit të deklaruar nga personi i interesuar.

7. Çdo institucion publik ose person fizik apo juridik duhet të plotësojë kërkesat e Avokatit të Popullit për informacion, dokumente ose materiale të tjera, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj, brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara nga Avokati i Popullit në kërkesat e tij.”.

Neni 6

Në nenin 31 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohen pika 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* çmon sipas bindjes së tij se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, në

përputhje me pikat 6 dhe 8 të nenit 21 të këtij ligji, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

2/2. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* ka të drejtë të kërkojë akses të plotë në të dhënat që i nevojiten për procesin e verifikimit dhe vlerësimit, duke përfshirë dokumente të shkruara, elektronike, regjistra publikë, si dhe çdo të dhënë tjetër të ligjshme që mbahet dhe përpunohet nga institucionet publike, personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë funksione publike sipas legjislacionit në fuqi.”.

2. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo organ publik është i detyruar të bashkëpunojë me Komisionin e Pavarur *Ad Hoc* për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, shkatërrimi i të dhënave, vonesat gjatë procesit të verifikimit përbëjnë shkelje disiplinore.

4. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* vendos që kandidati të mos kalojë verifikimin e pasurisë dhe figurës kur:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer fshehje pasurie, është kryer deklarim i rremë, subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesi bazuar në gjetjet e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe të fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit;

b) kandidati ka lidhje apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, siç përcaktohet në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, bazuar në kontrollin e kryer nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, si dhe fakteve, provave dhe dokumenteve që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit.”.

3. Në fund të pikës 5 shtohet togfjalëshi “dhe i jep një kopje të raportit të vlerësimit”.

4. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Në ushtrimin e veprimtarisë Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* respekton legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në rastet kur mbledh, përpunon, administron dhe ruan të dhëna personale.”.

Neni 7

Në nenin 35 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



1. Në pikën 1 fjalja e tretë ndryshohet si më poshtë:

“Asaj i bashkëngjitet dokumentacioni i plotë i dosjes së çdo kandidati dhe dokumentacioni i administruar gjatë procesit të vlerësimit, shoqëruar me inventarin e plotë.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Nëse dokumentacioni i kandidatit ose i institucioneve nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kriterëve profesionale e morale, sipas pikës 3 të nenit 19 dhe pikave 4 deri në 8 të nenit 21 të këtij ligji, Sekretari i Përgjithshëm i kërkon kandidatit ose institucioneve që brenda 30 ditëve të bëjnë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i dërgohet kandidatit në adresën elektronike të deklaruar. Sekretari i Përgjithshëm njofton menjëherë institucionet nga momenti i konstatimit të mangësive në dokumentacion.”.

3. Në pikën 4 togfjalëshi “5-ditor” zëvendësohet me togfjalëshin “30-ditor”.

4. Në pikën 7, shkronja “b”, fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Lista e kandidatëve të përjashtuar përmban emrat e tyre dhe analizën në mënyrë të mirarsyetuar për shkaqet e përjashtimit”.

5. Në pikën 8 pas fjalisë së parë shtohet fjalja me këtë përmbajtje:

“Sekretari i Përgjithshëm, nëse konstaton se ka mospërputhje të dukshme të rezultateve të raportit të vlerësimit me dokumentacionin e depozituar ose të administruar ose janë kualifikuar persona në kundërshtim me kriteret e këtij ligji, duhet të informojë kryetarin e komisionit parlamentar përgjegjës për çështjet ligjore.”.

Neni 8

Në nenin 36, pika 2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) të mos ketë masë disiplinore në fuqi, të mos jetë shkarkuar më parë nga detyra si rezultat i një mase disiplinore, në rastin e ish-magjistratëve të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ose të mos ketë dhënë dorëheqjen pa iu nënshtruar këtij procesi, ndërkohë që ka qenë subjekt rivlerësimi në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin

kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të mos jetë skualifikuar më parë nga pozicione të ndryshme për shkak të verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.”.

Neni 9

Në nenin 37, pika 1, fjalja e parë, togfjalëshi “4 muaj” zëvendësohet me togfjalëshin “10 muaj”.

Neni 10

Në nenin 39 shtohen pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“4. Pedagogët e interesuar brenda 15 ditëve nga shprehja e interesit duhet të dorëzojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave private për kontrollin e pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë në përputhje me nenin 3/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

5. Brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, pedagogët e interesuar dhe personat e lidhur me ta së bashku me deklaratën e pasurisë duhet të paraqesin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive.

6. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të kontrollit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit harton brenda 30 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit raportin për subjektin dhe e



përcjell sipas rastit pranë dekanit të fakultetit të drejtësisë ose drejtorit të Shkollës së Magjistraturës sa më shpejt të jetë e mundur, jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.

7. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, kandidatët e interesuar e dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar sipas kërkesave të ligjit për informacionin e klasifikuar pranë këtij institucioni.

8. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit sipas ligjit brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve të vetëdeklarimit dhe bashkëpunon me autoritetet ligjzbatuese për realizimin e kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit. Në përfundim të procedurës së verifikimit Autoriteti harton raportin për subjektin dhe e përcjell sipas rastit pranë dekanit të fakultetit të drejtësisë ose drejtorit të Shkollës së Magjistraturës sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.”

Neni 11

Në nenin 40 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Dekani i fakultetit të drejtësisë brenda 15 ditëve nga dorëzimi i shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqërues mbledh të dhëna për çdo person të interesuar nga Prokuroria e Përgjithshme, gjykata, administrata tatimore, autoritetet doganore, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit, si dhe nga çdo autoritet disiplinor dhe person fizik ose juridik që kanë të dhëna të vlefshme për qëllime verifikimi.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dekanati i fakultetit të drejtësisë ka të drejtë të kërkojë akses të plotë në të dhënat që i nevojiten për procesin e verifikimit dhe vlerësimit, duke përfshirë dokumente të shkruara, elektronike, regjistra publike, si dhe çdo të dhënë tjetër të ligjshme që mbahet dhe përpunohet nga institucionet publike, personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë funksione publike sipas legjislacionit në fuqi.

“1/2. Dekanati i fakultetit të drejtësisë çmon sipas bindjes së vet se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, në përputhje me pikat 6 dhe 8 të nenit 39, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

“1/3. Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo institucion publik dhe personat fizikë e juridikë janë të detyruar të bashkëpunojë me dekanatin e fakultetit të drejtësisë për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, shkatërrimi i të dhënave, vonesat gjatë procesit të verifikimit përbëjnë shkelje disiplinore.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Brenda 30 ditëve nga mbledhja e dokumentacionit nga institucionet publike ose personat fizikë dhe juridikë, dekanati i fakultetit të drejtësisë mbledhet në një mbledhje të posaçme për të verifikuar plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët. Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore dhe i mbështetjes është çështja e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së njësisë. Mosverifikimi i saktë i plotësimit të kushteve ligjore përbën shkelje disiplinore për anëtarët e dekanatit të fakultetit të drejtësisë.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Dekanati i fakultetit të drejtësisë vendos që kandidati të mos kalojë verifikimin e pasurisë dhe figurës kur:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer fshehje e pasurie, është kryer deklaram i rremë, subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesi bazuar në gjetjet e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe të fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit;

b) kandidati ka lidhje apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, siç përcaktohet në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar bazuar në kontrollin e kryer nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe të fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit.”.



5. Në pikën 5 fjalë e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Në rastin e kandidimit të drejtuesit të dekanatit, detyrat e tij kryhen nga një prej zëvendësdekanëve të Fakultetit të Drejtësisë ose pedagogu më i vjetër në detyrë i Fakultetit”.

6. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë dhe Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës në ushtrimin e veprimtarisë së tyre respektojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në rastet kur mbledhin, përpunojnë, administrojnë dhe ruajnë të dhëna personale.”.

Neni 12

Në nenin 53 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Sekretari i Përgjithshëm, nëse konstaton se ka mospërputhje të dukshme të rezultateve të raportit të vlerësimit me dokumentacionin e depozituar ose të administruar ose janë kualifikuar persona në kundërshtim me kriteret e këtij ligji, i propozon rektorit të IAL-ve fillimin e procedimit disiplinor për anëtarët e dekanatit të Fakultetit të Drejtësisë.”.

Neni 13

Në nenin 55, pika 1, fjalë e parë, togfjalëshi “4 muaj” zëvendësohet me togfjalëshin “10 muaj”.

Neni 14

Në nenin 56 bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1, 3/2, 3/3, 3/4 dhe 3/5 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kandidatët nga shoqëria civile brenda 15 ditëve nga shprehja e interesit duhet të dorëzojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave private për kontrollin e pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë në përputhje me nenin 3/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin e detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave

që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

“3/2. Brenda afatit të parashikuar në pikën 3/1 të këtij neni, kandidatët nga shoqëria civile dhe personat e lidhur me ta së bashku me deklaratën e pasurisë duhet të paraqesin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive.

“3/3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në deklarin e pasurive, zhvillon një procedurë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundimin të kontrollit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave harton brenda 30 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit raportin për subjektin dhe e përcjell pranë komisionit të shoqërisë civile sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.

3/4. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, anëtarët e shoqërisë civile dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar sipas kërkesave të ligjit për informacionin e klasifikuar pranë këtij institucioni.

3/5. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarin sipas ligjit brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve të vetëdeklarimit dhe bashkëpunon me autoritetet ligjzbatuese për realizimin e kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarin. Në përfundim të procedurës së verifikimit Autoriteti harton raportin për subjektin dhe e përcjell pranë Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.”.

2. Në pikën 9 afati “10 ditë” bëhet “30 ditë”.

3. Pas pikës 9 shtohen pikat 9/1 dhe 9/2 me këtë përmbajtje:



“9/1. Avokati i Popullit brenda 5 ditëve nga dorëzimi i shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqërues mbledh të dhëna për çdo person të interesuar nga Prokuroria e Përgjithshme, gjykata, administrata tatimore, autoritetet doganore, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit, si dhe nga çdo autoritet disiplinor dhe person fizik ose juridik që kanë të dhëna të vlefshme për qëllime verifikimi.

9/2. Çdo institucion publik ose person fizik ose juridik duhet të plotësojë kërkesat e Avokatit të Popullit për informacion, dokumente ose materiale të tjera, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj, brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara nga Avokati i Popullit në kërkesat e tij.”.

Neni 15

Në nenin 57 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Komisioni i shoqërisë civile çmon sipas bindjes së tij se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, në përputhje me pikat 3/3 dhe 3/5 të nenit 56 të këtij ligji, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

1/2. Komisioni i shoqërisë civile ka të drejtë të kërkojë akses të plotë në të dhënat që i nevojiten për procesin e verifikimit dhe vlerësimit, duke përfshirë dokumente të shkruara, elektronike, regjistra publike, si dhe çdo të dhënë tjetër të ligjshme që mbahet dhe përpunohet nga institucionet publike, personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë funksione publike sipas legjislacionit në fuqi.

Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo organ publik është i detyruar të bashkëpunojë me komisionin e shoqërisë civile për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, shkatërrimi i të dhënave, vonesat gjatë procesit të verifikimit përbëjnë shkelje disiplinore.

1/3. Komisioni i shoqërisë civile vendos që kandidati të mos kalojë verifikimin e pasurisë dhe figurës kur:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer fshehje pasurie, është kryer deklarim i rremë, subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesi bazuar në gjetjet e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe provave e fakteve që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit;

b) kandidati ka lidhje apo kontakte me persona të përfshirë në krim të organizuar, siç përcaktohet në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krim të organizuar bazuar në kontrollin e kryer nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe të provave e fakteve që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Në ushtrimin e veprimtarisë komisioni i shoqërisë civile respekton legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në rastet kur mbledh, përpunon, administron dhe ruan të dhëna personale.”.

Neni 16

Në nenin 98 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Aktet administrative individuale të Këshillit në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë për efekt të transparencës bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës. Përgjashtimisht, nuk publikohen të dhënat sensitive sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale të personave të tretë, që nuk janë subjekte të këtij ligji, mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për të dhënat personale.”.

Neni 17

Në nenin 117, pika 3, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) të mos ketë masë disiplinore në fuqi, të mos jetë shkarkuar më parë nga detyra si rezultat i një mase disiplinore, në rastin e ish-magjistratëve të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ose të mos ketë dhënë dorëheqjen pa iu nënshtruar këtij procesi, ndërkohë që ka qenë subjekt rivlerësimi në



përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të mos jetë skualifikuar më parë nga pozicione të ndryshme për shkak të verifikimit të pasurisë dhe figurës, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.”.

Neni 18

Në nenin 118, pika 1, fjalia e parë, togfjalëshi “4 muaj” zëvendësohet me togfjalëshin “10 muaj”.

Neni 19

Në nenin 119 pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“4. Avokatët e interesuar brenda 15 ditëve nga shprehja e interesit duhet të dorëzojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave private për kontrollin e pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë në përputhje me nenin 3/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin e detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

5. Brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, avokatët e interesuar dhe personat e lidhur me ta, së bashku me deklaratën e pasurisë, duhet të paraqesin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive.

6. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë kontrolli në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë, i ndryshuar, për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundimin të kontrollit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit harton brenda

30 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit raportin për subjektin dhe e përcjell pranë Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.

7. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, kandidatët e interesuar dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar sipas kërkesave të ligjit për informacionin e klasifikuar pranë këtij institucioni.

8. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit sipas ligjit brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve të vetëdeklarimit dhe bashkëpunon me autoritetet ligjzbatuese për realizimin e kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit. Në përfundim të procedurës së verifikimit Autoriteti harton raportin për subjektin dhe e përcjell pranë Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.”.

Neni 20

Në nenin 120 pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Avokati i Popullit brenda 15 ditëve nga dorëzimi i shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqërues mbledh të dhëna për çdo person të interesuar nga Prokuroria e Përgjithshme, gjykata, administrata tatimore, autoritetet doganore, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit, si dhe nga çdo autoritet disiplinor dhe person fizik ose juridik, që kanë të dhëna të vlefshme për qëllime verifikimi.

7. Çdo institucion publik ose person fizik ose juridik duhet të plotësojë kërkesat e Avokatit të Popullit për informacion, dokumente ose materiale të tjera, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj, brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara nga Avokati i Popullit në kërkesat e tij.”.

Neni 21

Në nenin 129 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



1. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* çmon sipas bindjes së tij se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, në përputhje me pikat 6 dhe 8 të nenit 119 të këtij ligji, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* ka të drejtë të kërkojë akses të plotë në të dhënat që i nevojiten për procesin e verifikimit dhe vlerësimit, duke përfshirë dokumente të shkruara, elektronike, regjistra publikë, si dhe çdo të dhënë tjetër të ligjshme që mbahet dhe përpunohet nga institucionet publike, personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë funksione publike sipas legjislacionit në fuqi.”.

3. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo organ publik është i detyruar të bashkëpunojë me Komisionin e Pavarur *Ad Hoc* për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, shkatërrimi i të dhënave, vonesat gjatë procesit të verifikimit përbëjnë shkelje disiplinore.

4. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* vendos që kandidati të mos kalojë verifikimin e pasurisë dhe figurës kur:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer fshehje e pasurie, është kryer deklaram i rremë, subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesi bazuar në gjetjet e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe të fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit;

b) kandidati ka lidhje apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, siç përcaktohet në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar bazuar në kontrollin e kryer nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit.”.

4. Në fund të pikës 5 shtohet togfjalëshi “dhe i jep një kopje të raportit të vlerësimit”.

5. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Në ushtrimin e veprimtarisë Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* respekton legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në rastet kur mbledh, përpunon, administron dhe ruan të dhëna personale.”.

Neni 22

Në nenin 134, pika 2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) të mos kenë masë disiplinore në fuqi, të mos jenë shkarkuar më parë nga detyra si rezultat i një mase disiplinore, në rastin e ish-magjistratëve të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ose të mos kenë dhënë dorëheqjen pa iu nënshtruar këtij procesi, ndërkohë që kanë qenë subjekt rivlerësimi në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të mos jenë skualifikuar më parë nga pozicione të ndryshme për shkak të verifikimit të pasurisë dhe figurës, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.”.

Neni 23

Në nenin 135, pika 1, fjalia e parë, togfjalëshi “4 muaj” zëvendësohet me togfjalëshin “10 muaj”.

Neni 24

Në nenin 137 pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“4. Pedagogët e interesuar brenda 15 ditëve nga shprehja e interesit duhet të dorëzojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave private për kontrollin e pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë në përputhje me nenin 3/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

5. Brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, pedagogët e interesuar dhe personat e lidhur



me ta së bashku me deklaratën e pasurisë duhet të paraqesin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të gjithë dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive.

6. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë kontrolli në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë, për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të kontrollit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit harton brenda 30 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit raportin për subjektin dhe e përcjell sipas rastit pranë dekanit të Fakultetit të Drejtësisë ose drejtorit të Shkollës së Magjistraturës sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.

7. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, kandidatët e interesuar dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar sipas kërkesave të ligjit për informacionin e klasifikuar pranë këtij institucioni.

8. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit sipas ligjit brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve të vetëdeklarimit dhe bashkëpunon me autoritetet ligjzbatuese për realizimin e kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit. Në përfundim të procedurës së verifikimit Autoriteti harton raportin për subjektin dhe e përcjell sipas rastit pranë dekanit të Fakultetit të Drejtësisë ose drejtorit të Shkollës së Magjistraturës sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.”

Neni 25

Në nenin 138 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Dekani i Fakultetit të Drejtësisë brenda 15 ditëve nga dorëzimi i shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqëruar mbledh të dhëna për çdo person të interesuar nga Prokuroria e

Përgjithshme, gjykata, administrata tatimore, autoritetet doganore, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit, si dhe nga çdo autoritet disiplinor dhe person fizik ose juridik që kanë të dhëna të vlefshme për qëllime verifikimi.”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë ka të drejtë të kërkojë akses të plotë në të gjitha bazat e të dhënave që i nevojiten për procesin e verifikimit dhe vlerësimit, duke përfshirë dokumente të shkruara, elektronike, regjistra publikë, si dhe çdo të dhënë tjetër të ligjshme që mbahet dhe përpunohet nga institucionet publike, personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë funksione publike sipas legjislacionit në fuqi”.

1/2. Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë çmon sipas bindjes së vet se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, në përputhje me pikat 6 dhe 8 të nenit 137 të këtij ligji, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

1/3. Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës çdo institucion publik dhe personat fizikë e juridikë janë të detyruar të bashkëpunojnë me dekanatin e Fakultetit të Drejtësisë për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, shkatërrimi i të dhënave, vonesat gjatë procesit të verifikimit përbëjnë shkelje disiplinore.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Brenda 30 ditëve nga mbledhja e dokumentacionit nga institucionet publike ose nga personat fizikë dhe juridikë, dekanati i Fakultetit të Drejtësisë mbledh në një mbledhje të posaçme për të verifikuar plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët. Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore dhe i mbështetjes është çështja e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së njësisë. Mosverifikimi i saktë i plotësimit të kushteve ligjore përbën shkelje disiplinore për anëtarët e dekanatit të Fakultetit të Drejtësisë.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:



“4/1. Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë vendos që kandidati të mos kalojë verifikimin e pasurisë dhe figurës kur:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer fshehje pasurie, është kryer deklarim i rremë, subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit bazuar në gjetjet e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe të fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit;

b) kandidati ka lidhje apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, siç përcaktohet në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar bazuar në kontrollin e kryer nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit.”.

5. Në pikën 5 fjalë e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Në rastin e kandidimit të drejtuesit të dekanatit detyrat e tij kryhen nga një prej zëvendësdëkanëve të Fakultetit të Drejtësisë ose pedagogu më i vjetër në detyrë i Fakultetit.”.

6. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6.1. Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë dhe Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës në ushtrimin e veprimtarisë së tyre respektojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në rastet kur mbledhin, përpunojnë, administrojnë dhe ruajnë të dhëna personale.”.

Neni 26

Në nenin 151 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Sekretari i Përgjithshëm, nëse konstaton se ka mospërputhje të dukshme të rezultateve të raportit të vlerësimit me dokumentacionin e depozituar ose të administruar ose janë kualifikuar persona në kundërshtim me kriteret e këtij ligji, i propozon rektorit të IAL-ve fillimin e procedimit disiplinor për anëtarët e dekanatit të Fakultetit të Drejtësisë.”.

Neni 27

Në nenin 153, pika 1, fjalë e parë, togfjalëshi “4 muaj” zëvendësohet me togfjalëshin “10 muaj”.

Neni 28

Në nenin 154 bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1, 3/2, 3/3, 3/4 dhe 3/5 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kandidatët nga shoqëria civile brenda 15 ditëve nga shprehja e interesit duhet të dorëzojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave private për kontrollin e pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë në përputhje me nenin 3/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin e detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

3/2. Brenda afatit të parashikuar në pikën 3/1 të këtij neni, kandidatët e interesuar nga shoqëria civile dhe personat e lidhur me ta së bashku me deklaratën e pasurisë duhet të paraqesin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive.

3/3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë kontrolli në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë, për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundimin të kontrollit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit harton brenda 30 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit raportin për subjektin dhe e përcjell pranë komisionit të shoqërisë civile sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.



3/4. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, kandidatët e interesuar të shoqërisë civile dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar sipas kërkesave të ligjit për informacionin e klasifikuar pranë këtij institucioni.

3/5. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit sipas ligjit brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve të vetëdeklarimit dhe bashkëpunon me autoritetet ligjzbatuese për realizimin e kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit. Në përfundim të procedurës së verifikimit Autoriteti harton raportin për subjektin dhe e përcjell pranë Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e përfundimit të raportit.”.

2. Në pikën 9 afati “10 ditë” bëhet “30 ditë”.

3. Pas pikës 9 shtohen pikat 9/1 dhe 9/2 me këtë përmbajtje:

“9/1. Avokati i Popullit brenda 5 ditëve nga dorëzimi i shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqëruar ka të drejtë të kërkojë të dhëna për çdo person të interesuar nga Prokuroria e Përgjithshme, gjykata, administrata tatimore, autoritetet doganore, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit, si dhe nga çdo autoritet disiplinor dhe person fizik ose juridik, që kanë të dhëna të vlefshme për qëllime verifikimi.

9/2. Çdo institucion publik ose person fizik ose juridik duhet të plotësojë kërkesat e Avokatit të Popullit për informacion, dokumente ose materiale të tjera, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj, brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara nga Avokati i Popullit në kërkesat e tij.”.

Neni 29

Në nenin 155 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Komisioni i shoqërisë civile çmon sipas bindjes së tij se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, në përputhje me pikat 3/3 dhe 3/5 të nenit 154 të këtij

ligji, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

1/2. Komisioni i shoqërisë civile ka të drejtë të kërkojë akses të plotë në të dhënat që i nevojiten për procesin e verifikimit dhe vlerësimit, duke përfshirë dokumente të shkruara, elektronike, regjistra publikë, si dhe çdo të dhënë tjetër të ligjshme që mbahet dhe përpunohet nga institucionet publike, personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë funksione publike sipas legjislacionit në fuqi.

Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo organ publik është i detyruar të bashkëpunojë me komisionin e shoqërisë civile për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, shkatërrimi i të dhënave, vonesat gjatë procesit të verifikimit përbëjnë shkelje disiplinore.

1/3. Komisioni i shoqërisë civile vendos që kandidati të mos kalojë verifikimin e pasurisë dhe figurës kur:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, është kryer fshehje pasurie, është kryer deklarim i rremë, subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesi bazuar në gjetjet e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe të fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit;

b) kandidati ka lidhje apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, siç përcaktohet në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar bazuar në kontrollin e kryer nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe të fakteve e provave që mund të kenë mbledhur nga institucione të tjera gjatë procesit të verifikimit.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Në ushtrimin e veprimtarisë komisioni i shoqërisë civile respekton legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në rastet kur mbledh, përpunon, administron dhe ruan të dhëna personale.”.

Neni 30

Në nenin 170 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:



“1. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të paktën 2 herë në vit dhe sa herë konsiderohet e nevojshme organizojnë mbledhje të përbashkëta për shkëmbimin e përvojave, për unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve, për ushtrimin e funksioneve dhe organizimit të tyre, si dhe për çështje të përgjithshme të lidhura me funksionimin e sistemit të drejtësisë.”

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, kryetarët e Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës ftohen të marrin pjesë në këto mbledhje të përbashkëta. Nëse është e përshtatshme, çdo palë tjetër e interesuar ftohen të marrin pjesë në këto mbledhje të përbashkëta.”

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“5. Me qëllim koordinimin e hartimit dhe zbatimit të politikave shtetërore në sektorin e drejtësisë, përfshirë në veçanti hartimin, zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mbi:

a) strategjitë, mbledhjen dhe analizën e të dhënave statistikore të lidhura me to, që hyjnë në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë, si edhe strategjitë ndërsektoriale;

b) udhërrëfyesit, planet e veprimit dhe dokumentet strategjike, si dhe mbledhjet dhe analizat e të dhënave statistikore të lidhura me to, që lidhen me procesin e integrimit evropian në sektorin e drejtësisë;

c) çështjet që lidhen me ndihmën e huaj;

Ministri i Drejtësisë thërret mbledhje koordinimi dhe miraton udhëzime të përbashkëta me titullarët e institucioneve përkatëse për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, përfshirë modelet, udhëzimet, afatet, monitorimin dhe raportimin.

6. Ministri i Drejtësisë drejton mekanizmat për koordinimin e integruar të politikave shtetërore në sektorin e drejtësisë. Mekanizmat për koordinimin e integruar të politikave shtetërore në sektorin e drejtësisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 31

Në nenin 190 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Aktet administrative individuale të Këshillit në lidhje me statusin e prokurorëve ose nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë për efekt të transparencës bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës. Përfshirë, nuk publikohen të dhënat sensitive sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale të personave të tretë, që nuk janë subjekte të këtij ligji, mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për të dhënat personale.”

Neni 32

Në nenin 209, pika 5, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) në kohën e komandimit të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se 10 vjet, prej të cilave jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar ose prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.”

Neni 33

Në nenin 210 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Inspektorët magjistratë dhe inspektorët jomagjistratë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gëzojnë pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të gjykatës së apelit.”

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 34

Në nenin 211 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

“Inspektorët magjistratë komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë riemërimi.”

2. Në pikën 2 pas fjalës së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Inspektorët e tjerë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendin e mëparshëm të punës ose në pamundësi në një detyrë të barasvlershme me të.”



Neni 35

Në nenin 244 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shkolla e Magjistraturës pranon në programin e trajnimit fillestar dhe vazhdues sipas ligjit kandidatët për këshilltarë dhe ndihmësligjor të gjykatave dhe prokurorive, si dhe të prokurorisë së posaçme sipas ligjit.”.

Neni 36

Në neni 264 bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Magjistrati që nuk ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve ose ka dhënë dorëheqjen, pa iu nënshtruar procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas vendimit përkatës të organeve kompetente, nuk mund të përzgjidhet në detyrën e pedagogut, trajnerit/ekspertit në programet e formimit fillestar dhe vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.”.

Neni 37

Neni 274 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 274

Konkurrimi, formimi fillestar dhe vazhdues i këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë të gjykatave dhe prokurorive

1. Konkurruesit për kandidatë për këshilltarë ligjorë dhe ndihmësligjorë të gjykatave dhe prokurorive, sipas kushteve të parashikuara në ligj, i nënshtrohen konkurrimit bazuar në një testim të posaçëm që hartohet nga Shkolla e Magjistraturës për profilet e punës së këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë. Për hartimin e testimit Shkolla e Magjistraturës këshillohet me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Gjykatën e Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme për tematikat e mundshme të testimit dhe aftësitë e nevojshme për t'u bërë këshilltarë ligjorë ose ndihmës ligjorë.

2. Programi i formimit fillestar të këshilltarëve ligjorë dhe ndihmësve ligjorë të gjykatave dhe

prokurorive përfshin një periudhë njëvjeçare që përbëhet nga një program i posaçëm teoriko-praktik, që synon të rrisë njohuritë në lëndë të ndryshme të së drejtës si dhe rrisë aftësitë praktike që kërkohen në ushtrimin e funksionit të këshilltarit ligjor ose ndihmësit ligjor.”.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 28.1.2026.

Shpallur me dekretin nr. 54, datë 11.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 54, datë 11.2.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 10/2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016, ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bajram Begaj

DEKLARATË

**PËR PAFAJËSINË E UDHËHEQËSVE
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË
KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në ushtrim të kompetencave të veta kushtetuese dhe në përmbushje të rolit të tij si përfaqësues i vullnetit të popullit shqiptar, shpreh shqetësimin e thellë për kërkesën përfundimtare të Prokurorisë Speciale të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,



zotërinjve Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi;

Kuvendi i Shqipërisë, duke mbajtur parasysh të vërtetën historike të luftës çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës, rithekson se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një lëvizje legjitime çlirimtare, që luftoi për të drejtat themelore të njeriut, për liri, dinjitet dhe vetëvendosje të popullit të Kosovës, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe Kartës së Kombeve të Bashkuara;

Kuvendi vëren me shqetësim se kërkesa e Prokurorisë Speciale rrezikon të krijojë një shtrembërim të rrezikshëm të historisë duke barazuar luftën legjitime të një populli për mbijetesë dhe liri me krimet e regjimit serb të Millosheviçit, i cili kreu spastrim etnik dhe krime kundër njerëzimit ndaj popullit të Kosovës;

Për këtë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë deklaron:

1. Mbështetjen e plotë e të pakushtëzuar për drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët ishin dhe mbeten përfaqësues të aspiratave të drejta të popullit të Kosovës për liri dhe vetëvendosje. Lufta e tyre ishte e drejtë, e mbështetur në parimet universale të të drejtave të njeriut.

2. Kërkesën drejtuar Dhomave të Specializuara në Hagë, komunitetit ndërkombëtar dhe institucioneve të drejtësisë ndërkombëtare që të deklarojnë pafajësinë e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit përmes një procesi të drejtë e të paanshëm, që respekton dhe nuk cenon dinjitetin e luftës çlirimtare të popullit të Kosovës, duke mos lejuar që instrumentet e drejtësisë të shndërrohen në mjete për rishkrimin e historisë ose për barazimin e viktimës me agresorin.

3. I kujton bashkësisë ndërkombëtare se lufta e UÇK-së u zhvillua në kushtet kur regjimi i Millosheviçit po bënte spastrim etnik, krime sistematike kundër njerëzimit dhe akte genocidiale ndaj popullsisë civile të Kosovës dhe se ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 konfirmoi legjitimitetin e asaj lufte dhe natyrën kriminale të regjimit të Millosheviçit.

4. Vlerësimin e lartë për dëshmitarët ndërkombëtarë të mbrojtjes, si Wesley Clark e James Rubin, të cilët konfirmuan të drejtën e

popullit të Kosovës dhe udhëheqësve të tyre për liri.

5. Solidaritetin e plotë me popullin e Kosovës e me familjet e drejtuesve të UÇK-së dhe rithekson se kombi shqiptar qëndron i bashkuar në mbrojtjen e së vërtetës historike dhe të dinjitetit të luftës për liri.

6. Angazhimin për të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm diplomatik dhe politik në forume ndërkombëtare për të siguruar që e vërteta historike për luftën çlirimtare të Kosovës të mos cenohet dhe drejtësia të ushtrohet në mënyrë të drejtë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u bën thirrje institucioneve të shtetit shqiptar, institucioneve të Republikës së Kosovës dhe diasporës shqiptare të qëndrojnë të bashkuar në mbrojtje të së vërtetës, dinjitetit dhe drejtësisë për popullin e Kosovës dhe për drejtuesit e luftës së tyre çlirimtare, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u rekomandon qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë për denoncimin ndërkombëtar të krimeve serbe në Kosovë.

Kjo deklaratë pasqyron vullnetin unanim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe u transmetohet Dhomave të Specializuara në Hagë, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Parlamentit Evropian, Asamblesë Parlamentare të NATO-s, OSBE-së, Këshillit të Evropës dhe të gjitha qeverive mike e partnere.

Miraturar në datën 12.2.2026.

MIRATOHET

KRYETAR
Niko Peleshi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

